

VENDIM
Nr.845, datë 3.12.2014

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË
NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE “ZARANIKË”, OBJEKTI “GROPAT E
BORËS”, TË RRETHIT ELBASAN, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“ELBESA” SHPK, PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR, PËR
SHFRYTËZIM GURI GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, pika 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të vendimit nr. 1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 1.5 ha, në ngastrën 66a, të ekonomisë pyjore “Zaranikë”, që do të përdoret nga shoqëria “Elbesa” sh.p.k., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, të hiqet nga Fondi Pyjor dhe Kulllosor dhe të regjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja, sipas ngastrave pyjore dhe kulllosore, jepet në lidhjen 1, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Heqja nga Fondi Pyjor dhe Kulllosor, për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror nga shoqëria “Elbesa” sh.p.k., të bëhet me pjesë, bazuar në grafikun e parashikuar të punimeve, lejes minerare të miratuar me aktin nr. 1203, datë 1.7.2008, për një sipërfaqe prej 0.015 km² e lejes mjedisore me nr. 273 dhe, mbi këtë bazë, shoqëria “Elbesa” sh.p.k., të realizojë rehabilitimin mjedisor të territorit pyjor.

3. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore dhe produkteve të tjera pyjore, sipërfaqet dhe investimet e kryera në vite në fondin pyjor dhe kulllosor, objekt i këtij vendimi, të paguhet nga shoqëria “Elbesa” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave””.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Elbesa” sh.p.k., brenda 2 viteve, të pyllëzojë, me fondet e veta, 4.5 ha sipërfaqe me drurë pyjorë, në ngastrat pyjore të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet saj dhe Ministrisë së Mjedisit.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të mbeten pronë publike e shtetit dhe të regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Elbesa” sh.p.k.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin e Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave dhe në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

7. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Elbesa” sh.p.k., të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët mbi hapat, afatet dhe procedurat për hartimin e projekteve teknike të heqjes së materialit drusor dhe pyllëzimin e sipërfaqeve pyjore, sipas pikës 4, të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN
 NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
 MINERAR NGA SHOQËRIA "ELBESA" sh.p.k. në rrethin e ELBASANIT

QARKU ELBASAN

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
EL 70 00 066a	Zaranikë	66 a	Ministria Mjedisit	1.5
GJITHSEJ				1.50

